



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 735/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 31.10.2018, shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Kërkesë për heqje dorë nga shqyrtimi administrativ i ankesës nr. 1478 prot., datë 11.09.2018 për procedurën e prokurimit me Nr.REF-82816-08-14-2018 me objekt: *“Mbikqyrje objekti: Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Besëlidhja”, qyteti Ballsh”*, me fond limit 1.217.265 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 27.08.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “Rean 95” sh.p.k.  
Rr. “Musa Karapici”, Nr.6, Tiranë

**Autoriteti Kontraktor:**

Bashkia Mallakastër  
Mallakastër

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për Prokurimin Publik”*, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”*, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 *“Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoji relatorin e çështjes dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## Vëren:


### I

#### ***Vlerësimi paraprak***

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës dhe të dokumentacionit të dërguar nga operatori ekonomik ankimues dhe autoriteti kontraktor, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit, mbështetur në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe, më pas, ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e percaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

I.3. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.



### II

#### ***Rrethanat e çështjes***

II.1. Në datën 16.08.2018 në sistemin e prokurimeve elektronike është publikuar procedura e prokurimit me Nr.REF-82816-08-14-2018 me objekt: “Mbikqyrje objekti: Rikonstrukcion i shkollës 9 vjeçare “Besëlidhja”, qyteti Ballsh”, me fond limit 1.217.265 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.08.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.

II.2. Në datën 29.08.2018 KVO-ja ka përfunduar në SPE vlerësimin dhe klasifikimin përfundimtar të ofertave. Ofertuesi ankimues është njoftuar elektronikisht për arsyet e skualifikimit të tij në procedurën e mësipëme të prokurimit.

II.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në autoritetin kontraktor në datën 03.09.2018, duke pretenduar se në tender, nga ana e tij është paraqitur tarifa e detajuar sipas VKM-së. Gjithashtu ngrihen pretendime për shoqërinë “Arena MK” sh.p.k.

II.3. Në datën 04.09.2018 autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje në lidhje me ankesën e paraqitur pranë këtij të fundit me anë të shkresës nr.1938/1prot., datë 04.09.2018, duke mos e pranuar atë.

II.4. Në datën 11.09.2018 operatori ekonomik ankimues, ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke kundërshtuar skualifikimin e tij si dhe duke pretenduar kualifikimin e padrejtë të shoqërisë "Arema MK" sh.p.k.

II.5. Në datën 19.09.2018 është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1478/2 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 2033/1 prot., datë 17.09.2018 me objekt: *"Informacion mbi procedurën e prokurimit me Nr.REF-82816-08-14-2018 me objekt: "Mbikqyrje objekti: Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Besëlidhja", qyteti Ballsh", me fond limit 1.217.265 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 27.08.2018"*, bashkëlidhur informacioni dhe dokumentacioni mbi zhvillimin e procedurës së prokurimit dhe trajtimin e ankesës.

II.6. Në datën 29.10.2018, operatori ekonomik ankimues ka paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik një kërkesë me anë të së cilës kërkon të heqë dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit me Nr.REF-82816-08-14-2018 me objekt: *"Mbikqyrje objekti: Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Besëlidhja", qyteti Ballsh", me fond limit 1.217.265 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 27.08.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.*



### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të kërkesës së operatorit ekonomik ankimues,

#### **Arsyeton:**

III.1. Lidhur me kërkesën e operatorit ekonomik ankimues "Rean 95" sh.p.k. për të hequr dorë nga ankesa e bërë në lidhje me procedurën e prokurimit me Nr.REF-82816-08-14-2018 me objekt: *"Mbikqyrje objekti: Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare "Besëlidhja", qyteti Ballsh", me fond limit 1.217.265 lekë pa TVSH, zhvilluar ne daten 27.08.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.1. Duke qënë se një situatë e tillë nuk është e rregulluar nga ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 *"Për Prokurimin Publik"*, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik i drejtohet ligjit nr.44/2015 *"Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë"* i cili në nenin 94, *"Tërheqja e kërkesës apo braktisja e procedurës"*, pika 1 parashikon se *"Si rregull, në procedurën*

*administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaroi përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë.”*

III.1.2. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik ankimues është në të drejtën e tij të kërkojë të heqë dorë nga pretendimet e parashtruara në objekt ankimimin e tij, dhe si pasojë mos shqyrtimit të ankesës së tij nga KPP lidhur me këto pretendime. Heqja dorë nga ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues sjell si rrjedhojë përfundimin e procedimit administrativ pa një vendim përfundimtar për çështjen.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të përfundojë procedimin administrativ për procedurën e prokurimit me Nr.REF-82816-08-14-2018 me objekt: *“Mbikqyrje objekti: Rikonstruksion i shkollës 9 vjeçare “Besëlidhja”, qyteti Ballsh”*, me fond limit 1.217.265 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 27.08.2018 nga autoriteti kontraktor Bashkia Mallakastër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 1478 Protokolli**

**Datë 11.09.2018**

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Enkeleda Bega**

**Anëtar**  
**Vilma Zhupaj**

**Anëtar**  
**Lindita Skeja**

**Anëtar**  
**Merita Zeqaj**

**Kryetar**  
**Evis Shurdha**